



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik  
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 060/01-28990/20  
Kaçanik, 23.12.2020

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e X-të (Dhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2020 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 23 Nëntor 2020. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve të KK, pjesëmarrës në mbledhje fillimi ishin 24 anëtarë, ndërkaq pas përfundimit të pikës 3, arriti anëtarja Albana Lika (Troni), kështu që konstatohet së pjesëmarrës të kësaj mbledhje ishin 25 anëtarë. Gjatë tërë mbledhjes munguan me arsyé dy anëtarë; Ahmet Luma dhe Nazife Krasniqi.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtori e drejtive komunale; Bahri Selimi, Ramadush Osmani, Ukshin Qallaku, Festim Neziraj, Fatmir Loku dhe Diana Reka, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Bejtulla Dalloshi, Arbnora Kuka, Ilirjana Berisha, Xhelal Dema dhe Ilir Lumi.

Nga OJQ (KDI), mbledhjen e monitoroj, Kijani Sallahu.

Nga strukturat vendore, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli**, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përvshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, konstatoj pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër të gjithë anëtarët. Kuorumi ekziston, dy anëtarë: Nazife Krasniqi dhe Ahmet Luma nuk vijnë për shkaqe të arsyeshme për shkak të infektimit me Covid-19, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e X-të (Dhjetë) të Rregullt për vitin 2020, data 23 Nëntor, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti Nëntëmujor financiar për periudhën: Janar- Shtator 2020;
3. Propozim Vendimi për transfer të mjeteve buxhetore të kategoria e Pagave dhe Mëditjeve, sipas buxhetit të vitit 2020;
4. Propozim Rregullore për caktimin e procedurave të dhënes në shfrytëzim me pak së një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës;
5. Propozim Vendimi për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të KK 01Nr. 104/02-12813/2018 të datës 27.04.2018 - për formimin e Komitetit për Shërbime Publike;

6. Propozim Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021;
7. Kërkesa e anëtares së KK nga AAK, Rabije Sallahi, për ndryshim plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF);
8. Propozim Vendimi për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01.Nr.104/01-1879/18 i datës 28.02.2020 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi(KKSB); dhe
9. Propozim Vendimi për caktimin e normave tatumore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.

Pika 9 nuk ka qenë e paraparë në ftesën për mbledhje, materiali për këtë pikë është dërguar me vonë. Rendin e propozuar të punës me shtimin e pikës 9 e shtroj në votim për aprovim. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

**Aprovoj**

**Rendin e punës në përbërje prej 9 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbal i mbledhjes se kaluar të Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

**Aprovoj**

**Procesverbalin e mbledhjes së IX (Nëntë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 30.10.2020/ Lënda: 01Nr. 060/01-26878//20.**

### **Pyetje dhe Kërkesa**

**z. Ekrem Kyçiku**, Fillimi shtiu uroj festat e nëntorit, ndërkaq parashtroj këto pyetje:

1. Është hera e katërt që parashtroj pyetje lidhur me realizimin e projektit, Shtrimin me kubëza të pjesës së rrugës në qytet. Pyetja ime ka qenë, A e ka tejkaluar afatin në realizimin e projektit kompania kontraktuese ? Nëse e ka kaluar afatin e realizimit të projektit, a i është shqiptuar gjobë kompanisë në fjalë?

2. Pyetje për DUKMM, A vlejnë ligjet e ndërtimit e banesave për të gjithë operatorët që ndërtojnë banesa, sepse njëherë po lejohet të tejkalohet plani i ndërtimit, pastaj prishet objekti i ndërtuar. Është mirë me marrë një përgjigje nga drejtori i DUKMM, se a vlejnë ligjet njësorë për të gjithë operatorët e ndërtimit ?

**znj. Kaltrina Kodra (Tafili)**, Së pari po e ri përsërisë Kërkesën time të cilën e kam ngritur edhe në mbledhjen e kaluar të KK për raportim të rregullt në KK për çështjen e pandemisë e sidomos tani kur kemi informata së dy shkolla të komunës janë në procedurë të mbylljes për shkak të infektimit të arsimtarëve me Covid-19.

2. Tani po e ngriti një Kërkesë të cilën e kam pranuar nga f. Dubravë; Unë kam kontaktuar dhe kam vizituar këtë fshat dhe i kam parë problemet e këtij fshati. Ndër kërkesat kryesore të këtij fshati është çështja e ujit. Po bëhen 1 vit apo më tepër që kur është ndërtuar rezervari i ujit ndërkaq komuniteti i këtij fshati nuk ka ujë. Lagja Imisht është një ndër lagjet që ka

rezervuarin më së afërmi, ndërkaq kjo lagje nuk ka ujë fare, e mos të flasim për lagjet tjera. Lagjja Vataj nuk është e kyçur fare në ujësjellës. Në lagjen, Vataj e Epërme është problem mungesa e trotuarit dhe ndriçimit publik, që është nevojë e qytetarëve e sidomos për fëmijët të cilët vijojnë në shkollën në atë anë, të cilët shkojnë përmes rrugës kryesore. Kisha dashur me ditur, Kur do të bëhet ndriçimi dhe trotuari në atë pjesë ? Të lagja Dullovi, është bërë ndërtimi i një muri mbrojtës, ndërkaq nuk është bërë drenazhi, me çka ka filluar tokatë dëmtohen, qytetarët e asaj pjese janë mjaft të shqetësuar për këtë çështje.

**z. Adnan Reka,** Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë;

1. Kam një Kërkesë nga banorët e rrugës Lepenci, që t'ua shtroni rrugën që ende e kanë me baltë, ndërkaq për ndriçim publik as që bëhet fjalë për atë pjesë, ndoshta e konsideroni luks për ata banorë.
2. Sapo erdha nga shkolla dhe dua t'ua përcjell një shqetësim të mësimdhënësve të shkollës "Idriz Seferi". Kërkojmë që t'ju paguhen shumat sipas marrëveshjes kolektive, përkundër t'rheqjes se padisë që kane bërë në Gjykatë, janë e vtmja shkollë në Komunën e Kaçanikut të cilët nuk i kanë marrë këto para. Prandaj kërkojmë që të paguhen shumat e parapara, sepse mund të përballeni me grevë të mësimdhënësve.

**z. Ekrem Raka,** Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë; Kërkoj nga Kryetari i Komunës, t 'na jep sqarim lidhur me këtë çështje; Në një TV dëgjova që katër (4) komuna të Kosovës kanë vendosur mos me stolisur qytetin e tyre për festa. Në mesin e këtyre komunave është edhe Komuna e Kaçanikut. A është i vërtetë ky lajm apo jo ?

**Kryetari i Komunës, Besim Ilazi,** Unë nuk e di z. Ekrem ku e ke dëgjuar atë informacion, Ne ende nuk kemi ndonjë qëndrim as "Për" e as "Kundër "për me stolisur qytetin, për shkak të situatës. Në momentin që ndryshon situata, do të dalim më qëndrim për ose kundër, dhe do të njoftoheni me qëndrimin e marrë.

**z. Ekrem Raka,** Të çështja e stolisjes së qytetit për festa, unë mendoj së nuk mundet me marrë vendim Kryetari i Komunës as ekzekutivi, sepse vendimin për mos me stolisur qytetin duhet me marrë Kuvendi i Komunës si përfaqësues i popullit të komunës.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi,** Nuk e di z. Ekrem ky i keni marrë këto informacione. Unë në momentin që marrë qëndrim, do të dal para juve dhe e arsyetoj vendimin, mirëpo nuk kam marrë qëndrim as vendim për këtë çështje. Nëse merret vendim për jo, kjo po i bien njëfarë kërcënimi nga ana e juaj. Në momentin që e marrë vendimin, unë do e arsyetojmë të njëjtin, ndërkaq po me duket e paarsyeshme kjo që po e thua tani.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse Kryetar i Komunës ka të drejtë për me dekoruar qytetin, atëherë ka të drejtë me marrë vendim edhe mos me dekoruar, se më duket se e thatë së për "me vendosë për jo" nuk ka të drejtë me vendosë kryetari. Si do që të jetë, çështja e zbukurimit të qytetit është në kompetenca të ekzekutivit e jo kompetencë e Kuvendit të Komunës. Ne mund të trajtojmë edhe në KK këtë çështje, megjithatë kjo çështje është në kompetenca të ekzekutivit të komunës.

**z. Agim Mani,** Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë; Shqetësimi im dhe i qytetarëve është, hedhja e mbeturinave në rrugën e quajtur "Ruga e Kuqe", e cila rrugë është 100 metra nga rruga magjistrale. Aty janë hedhur mbeturina të përditshme dhe kjo rrugë është

bllokuar dhe po shndërrohet në deponi, me çka pos tjerash mund të jetë rrezik për qytetarët që kalojnë atypari nga qentë endacak.

**z. Selim Reka**, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit; Shqetësimi im është për lokalet në komunën tonë e sidomos për kafiteritë, mos zbatimi i rregullave anticovid. Këtë po e themi sepse të gjithë kamerierët shërbejnë pa maska, në tavolinë rrallë ndonjë kafiteri që ka të vendosur dezinfektues. Pyetja e ime është, A po dalin në teren inspektorët e komunës me shikuar këtë çështje, kur dihet fakti se tani në komunën tonë ka filluar rritja e të infektuarve nga Covid-19.

**z. Bekim Koxha**, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, Shqetësimi i kahershëm banorëve të lagjes Koxhaj është çështja e ujit të pijes. Në f. Koxhaj nuk ka ujë jo vetëm sot por që 20 vite - nga pas lufta. Arsyet janë të ndryshme, drejtori ndoshta mundet me na dhënë sqarime më të hollësishme, sepse qytetarët janë duke pasur telashe në këtë drejtim, kur dihet se edhe bunarët kanë shterë. Kërkoi që drejtori të bëjë një farë plani për ujin e pijes, sepse banorët e asaj pjese janë në hall për ujin e pijes dhe nuk janë duke ditur se çka me bërë. Është mirë drejtori t'na tregoj së, A ka ndonjë projekt që në të ardhmen – brenda muajit me u bërë ndonjë zgjidhje për ujin e pijes të f. Koxhaj.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Kërkesa të tjera nuk ka, atëherë vazhdojmë më pikët sipas radhës:

**2. Raporti Nëntëmujoor financiar për periudhën: Janar- Shtator 2020;**

Materialin e keni marrë, në KPF është kërkuar nga z. Ekrem Kyçyku që materiali të plotësohet edhe me dy tabela shtesë. Besoj se ato tabela janë dërguar. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin;

**z. Ekrem Kyçyku**, Faleminderit kryesues, Nga raporti financiar shihet se implementimi i buxhetit për periudhën janar-shtator është vetëm 52.78%. Të HVK nga participimet dhe donacionet janë vetëm 13 %. Inkasimi i të HVK të disa drejtori është shumë i vogël, si të DBPZHR dhe të DSHMS. Të kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale, janë realizuar 24% e që në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është një rënie prej 48.07%. Subvencionet dhe transferet janë realizuar 20.85%, ose në një rënie për 57.53%. Unë në KPF kam thënë që Raportit i ka munguar Tabelari lidhur me Shpenzimet për Mallra e shërbime si dhe Tabelari për Planifikimin e buxhetit, alokim dhe shpenzime. Të tabelari analistik i shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve e kam një pyetje, Është një shpenzim prej 400 € e qomyrit të Zyra e kryetarit dhe shpenzimet për ngrohjes-dru, 47,475.00€. A është duke u përdorur ende qomyri për ngrohje dhe sa ka kushtua përafersisht 1 m<sup>3</sup> dru ?

**z. Ekrem Raka**, Fillimisht e kuptoj se jemi në kohë pandemie dhe e kuptoj realizimin e buxhetit në përqindje shumë të vogël, megjithatë më brengosë fakti që granti qeveritar është realizuar vetëm 57 %. Ne e dimë së, nëse mbesim mjete nga granti qeveritar, ato mjetet kthehen në neveri si suficit buxhetor.

**z. Selim Reka**, Faleminderit kryesues; Unë vërejtjet e mia të cilat i kam pasur, i kam ngritur në KPF. Kur e kemi pasur në shqyrtim reportin 6 mujoor financiar, ka pasur arsyet për realizim të vogël të buxhetit, ndërkaq në këtë raport financiar, brenga me e madhe është për realizimin e ulët të buxhetit të investimet kapitale të cilat mjete janë realizuar vetëm 23.68%. Vërejtje ime dhe e qytetarëve është së, është vështirë të realizohen shpenzimet në këtë program buxhetor për

tre muajt e mbetur edhe pse dihet së kërkesat dhe nevojat e qytetarëve janë të mëdha. Çështja është që këto mjete - mjetet të shpenzimet kapitale të shpenzohen në vendin e duhur e mos të shpenzohen shkel e shko.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Për sqarime të nevojshme në çështje që u ngiten në raportin finansiar, fjalën ia kaloj drejtorit të DEFZH, Bahri Selimi.

**z. Bahri Selimi-drejtor i DEFZH,** Faleminderit, përshëndetje për të gjithë; Ndoshta situatë jo koherente në mes të periudhës të cilën po flasim për realizim të buxhetit dhe tani, për shkaqe procedurale, raporti është ofruar me vonesë. Nuk ka nevojë për shqetësimë, tani jemi në muajin nëntor, ndërkaq përqindja e realizimit të buxhetit ka shënuar progres si të investimet kapitale dhe kategoritë tjera ekonomike të shpenzimeve. Shpenzimet për periudhën 9 mujore janë 52.78 %. Të HVK janë 13.63% janë shpenzimet të kjo kategori ekonomike. Këtu është fjalë të shpenzimet e jo të inkasimi, së dikujt mundet me iu ngatërruar kjo shifër, Ekremi është duke bërë pyetje për shpenzimet. Mjete të bartura nga viti 2019 në vitin 2020 janë 13% dhe participimet 23.12%. Për shkak së GQ nuk kthehet ndërkaq të HVK iu epërt mundësia me u kthyer, me qëllim nuk i shpenzojmë të HVK para GQ. Të te HVK të DBPZHR dhe të DSHMS të Shëndetësia janë participimet të cilat kemi vendosur në KK me i liruar qytetarët nga këto pagesa. Të hyrat nga qiraja të Urbanizmi dhe të hyrat në Shëndetësi ka vendosur KK për lirimin e tyre në një mbledhje. Për të HVK të Bujqësia nuk kam informatë për zvogëlimin e tyre. Tabelën njëren e kam dërguar, Tabelën përmallrat dhe shërbimet, ndërkaq tabelën tjetër për Planifikimin e buxhetit, alokim dhe shpenzime kam më ofruar. Të lëndët djegëse-dru, 45 euro është 1m3dru. Të Investimet Kapitale (IK), shqetësimi është me vend, mirëpo disa procedura të prokurimit për shkak të pandemisë janë realizuar me vonesë, gjithashtu edhe çështja e alokimit të mjeteve. Është viti i parë që nuk i kemi pasur qind për qind mjetet për investime kapitale në buxhet. Në mungesë të mjeteve nga qeveria apo tkurrje-ngadalësim i realizimit të buxhetit, komunave iu kanë realizuar 50% të mjeteve. Ne drejtorët e drejtorive kemi bërë kërkesa për me i realizuar projektet, mirëpo kur ka ardhur puna me lidhur kontrata, Zyra e prokurimit, ashtu kërkohet me ligj, nuk i ka lidhur kontratat me 50% të mjeteve, derisa nuk janë alokuar të gjitha mjetet. Ka edhe ngecje tjera, si të pritet rreth ankesave të operatorëve, të tjera. Deri tani iu garantoj së ka shumë progres të investimet kapitale, besoj deri në fund të vitit investimet kapitale do të realizohen mbi 75% që e parashohin organet-donorët që po jepin grantin e përfomancës –DEMOS etj. E jona është me synuar realizimin 100%, një pjesë e investimeve mbesin pa shpenzuar, për shkak krejt të HVK nuk mblidhen gjatë vitit, apo mblidhen në tre muajt e fundit të vitit dhe nuk mund t'i shpenzojmë.

**z. Ekrem Kyçyku,** Kërkoi përgjigje për 400€ të shpenzuara për qymyr të Zyra e Kryetarit të Komunës dhe a është duke u përdorur ende kjo lëndë djegëse në komunën tonë ?

**z. Bahri Selimi,** Një 400€ është të Zyra e Kryetarit të Komunës, ka mundësi është bërë ndonjë gabim, këtu është një klasë - derive, dru për nxehje, qymyr, është kodi 13750 në vend së me shkruar 13760 i cili është i përafërt ose mos e kam paguar ndonjë borgj të vitit të kaluar, përndryshe qymyrin e kemi hequr nga përdorimi.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Raporti Nëntëmujor finansiar për periudhën: Janar- Shtator 2020 ishte sa për njoftim, kështu që konstatohet se Kuvendi i Komunës u,

**Njoftua**

**Me Raportin Nëntëmujor finansiar për periudhën: Janar- Shtator 2020 / Lënda: 01Nr. 05-400/01-26989/20.**

3. Propozim Vendimi për transfer të mjeteve buxhetore të kategoria e Pagave dhe Mëditjeve, sipas buxhetit të vitit 2020;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Drejtori është prezent këtu për sqarime të nevojshme. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku**, Ne LVV do të abstenojmë në këtë çështje, për faktin së të gjithë punëtorët e sektorit publik duhet trajtohen njësoj, e jo vetëm sektori i Arsimit dhe sektori i Shëndetësisë, të cilëve po iu bëhen këto kompensime.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk pati Abstenuan 6 anëtarë të LVV (Ekrem Kyçyku, Adnan Reka, Agim Mani, Fatijona Kyçyku, Kaltrina Kodra (Tafili), Shemsedin Luzha) dhe Ekrem Raka. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

Për transfer të mjeteve buxhetore të kategoria e Pagave dhe Shtesave sipas buxhetit të vitit 2020 nga 7 Nën programe, në Nën Programin, Shërbimet e Shëndetësisë Primare për mbulimin e obligimeve të stafit mjekësor për shpërblime jubilare sipas Kontratës Kolektive në mes Sindikatës së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë Nr. 05-3815 e datës 12.06.2020 / Lënda : 01Nr. 104/02-28969/20.

4. Propozim Rregullore për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim me pak së një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Drafti i Rregullores është model për të gjitha komunat e Kosovës, drafti iu ka nënshtruar procedurës së debatit publik me qytetarë. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Raka**, Faleminderit kryesues; Unë jam për miratimin e kësaj rregulloreje, nëse paragrafi 2.2. i nenit 5 që parashev dhënien në shfrytëzim; Shtëpitë e kulturës, kinematë, teatrot dhe terrenet rekreative-sportive, të hiqet. Unë e konsultova Ligjin Nr. 06/L-092, mbi bazën e të cilës është nxjerrë kjo rregullore, sipas të cilës komuna ka të drejtë më dhënë në shfrytëzim pronën e paluajtshme në të cilën përfshihen objektet e pronës komunale. Kjo tingëllon shumë keq dhe për mua është shumë e vrazhdët në një mjesid që ka probleme me kulturën, me dhënë në shfrytëzim objektin e shtëpisë së kulturës.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Rregullorja e përcakton procedurën së si duhet me u dhënë një pronë në shfrytëzim, së ka pasur keqkuptime në rrjetet sociale, sepse për më i dhënë pronat në shfrytëzim vendosë dikush tjetër dhe përsëri çështja vjen në KK dhe vendosë KK. Drejtori si duket nuk ka diçka me shtuar, diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 7 anëtarët nga LVV (Ekrem Kyçyku, Adnan Reka, Agim Mani, Fatijona Kyçyku, Kaltrina Kodra (Tafili), Shemsedin Luzha, Albana Lika (Troni) dhe Ekrem Raka. Abstenoj Bekim Koxha. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

#### APROVOJ

Rregullore për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim me pak së një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës/ Lënda: 01Nr. 02-104/02-26493/20.

**5.** Propozim Vendimi për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të KK 01Nr. 104/02-12813/2018 të datës 27.04.2018 - për formimin e Komitetit për Shërbime Publike;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Materialin e keni marrë, ndërkaq nga propozimi që e pash në material, propozimi nga OJQ ka ardhur nga z. Kijani Sallahu e që njëherë është i propozuar për anëtar të këtij komisioni. Mendimi im është, çështja e propozimit të anëtarit të kthehet edhe një herë të OJQ dhe të nënshkruhet nga dikush tjetër, për shkak së kjo paraqet konflikt të drejtpërdrejtë të interesit. E drejta ime është më dhënë mendimin tim, ndërkaq vendimi është i juaji. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku,** Edhe unë e pata ndërmend me cekur propozimin që e ka dhënë z. Kijani Sallahu nga OJQ. Ka pasur konsultime të forumit të OJQ për këtë çështje, por nuk është caktuar kandidati. Unë jam anëtar i OJQ- Bjeshkatarëve dhe nuk jemi thirrur asnjëherë për këtë çështje dhe jemi shoqatë aktive dhe kujtoj së propozimi qysh është dhënë nuk është në rregull.

**z. Nexhat Loku,** Në emër të PDK konfirmoj se jemi me shtyrë këtë çështje për mbledhjen vijuese për arsyet e theksuara.

**z. Adnan Reka,** Kjo është në sh përputhje plotësisht me nenin 12 të LVL të cilën i referoheni, thuhet së duhet t'i referoheni Statutit të Komunës, ndërkaq statuti i komunës e përcakton shumë qartë si në Udhëzim Administrativ ( UA).

**Kryesuesi i Kuvendit,** Më shtyrë për mbledhjen vijuese këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 2 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së KK vendosi që kjo pikë t'i kthehet propozuesit, në mënyrë që të rregullohet çështja e propozimit të anëtarit nga OJQ.

**6.** Propozim Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Plani i Punës së KK është hartuar nga komisioni i kuvendit i cili u formuar në mbledhjen e kaluar. Plani është orientues, i përmban çështjet bazike që duhet të diskutohen. Plani mund të ndryshohet dhe plotësohet sipas kërkeseve dhe nevojave që dalin. Unë kam qenë edhe vet pjesë e komisionit. Në vitin 2021 janë paraparë 12 mbledhje të rregullta. 2 mbledhjet e fundit ka mundësi të mos mbahen, për shkak së viti 2021 është vit zgjedhor dhe të njëjtat e shikojmë nëse mundemi më i mbajtur me herët. Për këtë pikë e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Me të cilin e Aprovoj Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021 / Lënda: 01Nr. 060/01-28891/20.**

**7.** Kërkesa e anëtares së KK nga AAK, Rabije Sallahi, për ndryshim plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF);

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kërkesën e keni marrë, kërkesa më është adresuar edhe mua me shkrim dhe e kam sjell në KK. Kërkesa është e bazuar në UA, që e rregullon çështjen e komiteteve të përhershme të KK. Unë mendoj se anëtarja në fjalë ka të drejtë në kërkesën e saj, ndërkaq nuk

do të thotë së është e drejtë ajo që mendoj unë. Si do që të jetë vendosët këtu. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku**, Faleminderit kryesues, Unë e kam konsultuar UA 02/2018 që ka të bëjë me plotësimin ndryshimin e UA Nr. 03/2018 –për procedurën e themelimit, përbërje dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë. Pikë së pari, kuvendet komunale kanë qenë të obliguara të bëjë harmonizimin e komiteteve të përhershme deri me 31 mars 2019, ndërkaq kjo nuk është bërë në komunën tonë. Nëse do ishte bërë harmonizimi i komiteteve të përhershme në bazë të këtij UA, atëherë KPF do të kishte përbërjen prej përfaqësuesve të subjekteve politike të përfaqësuara në KK. Kuvendi i Komunës Kaçanik ka 6 subjekte politike dhe ka vend për të gjithë me u anëtarësuar në komitete. Pse nuk janë bërë këto ndryshime ju e dini me mirë. Këtë çështje do të ngriti edhe në MAPL.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Sa i përket përfaqësimit të te gjitha subjekteve politike në komitetet e përhershme, ne e kemi pasur këtë problem edhe më herët me rastin e themelimit të komiteteve. Ju e dini mirë së këtë kërkesë e keni bërë në MAPL dhe e dini përgjigjen si na ka ardhur. Pas kësaj ka rrjedhur edhe ndryshim plotësimi i UA, ku ceket qartë së përbërja e KPF duhet të reflektoj numrin e ulëseve të subjekteve politike në KK. Duke marrë parasysh këtë, UA i ka cekur vetëm nenet të cilat kanë pasur zbrazëtirë të komitetet, por e ka lënë të paprekur nenin 13 të UA të vjetër, ku në pikën 3.5 e thotë qartë; Kur anëtarë kalon në etnitet tjetër politik, zëvendësohet me anëtarin e të njëjtë etnitet politik që i ka takuar kandidati me rastin e zgjedhjes. Pos kësaj, kemi pasur raste të ngjashme të çështja e ish anëtarit Hajdar Loku, kur ka kaluar në subjekt tjetër politik, ku në bazë të vlerësimit të MAPL është dashur të liroj vendin në KPF që e ka marrë si përfaqësues i subjektit politik që i ka takuar me herët. Për mua kërkesa ka bazë. Sido që të jetë, vendimi shkon në MAPL për shqyrtim të ligjshmërisë dhe autoriteti mbikëqyrës e vlerëson vendimin. Në këtë rast nuk dua të keqkuptohem nga askush, por po mundohem me e zbatuar atë që jep ligji dhe UA për këtë çështje.

**z. Ekrem Raka**, Unë e kam konsultuar Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe Ligjin për zgjedhjet lokale, ku sipas këtyre ligjeve, mandati është i të zgjedhurit të popullit, mirëpo votat i mbësin subjektit politik. Në rastin konkret, anëtarë i cili ka lëvizur në subjekt tjetër politik, votat që i ka ftuar anëtarë nga AAK i mbësin subjektit politik të AAK pavarësisht nga lëvizë kandidati. Fjala vjen, pavarësisht me sa anëtarë ka mbetur AAK, mbetet subjekti i katërt politik në bazë të numrit të votave që ka fituar në zgjedhjet lokale.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Kërkesën e Rabije Sallahi e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë ishin 7 anëtarë të LVV (Ekrem Kyçyku, Adnan Reka, Agim Mani, Fatijona Kyçyku, Kaltrina Kodra (Tafili), Shemsedin Luzha dhe Albana Lika (Troni), Abstenoj Lirije Qeli. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

Me të cilin Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-1785/2018 i datës 24.01.2018- përkatësisht Vendimit për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-5524/2018- për Ndryshim Plotësimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa i datës 28.02.2018, ashtu që;

1. Nga Komiteti për Politikë dhe Financa hiqet anëtarja, Albana Lika (Troni), për shkak të kalimit të saj në subjekt tjetër politik, Lëvizjen Vetëvendosje (LVV).

**2. Për anëtare të Komitetit për Politikë dhe Financa caktohet, Rabije Sallahi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).**

Lënda 01 Nr.060/01-27538/20.

8. Propozim Vendimi për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01.Nr.104/01-1879/18 i datës 28.02.2020 Për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi(KKSB);

**Kryesuesi i Kuvendit,** Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me ndryshim plotësimin e KKSB, këtu propozimi për anëtarin nga OJQ është në rregull me letra. Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin:

**z. Selim Reka,** Pasi që bëhet fjalë për emrin e valluat tim, unë do të abstenoj në këtë pikë për shkak të konfliktit të interesit.

**z. Ekrem Kyçyku,** Unë e potencova qëndrimin tim më herët, për shkak të paligjshmërisë së forumit të OJQ, po me duket se këto vendime që po merren, janë të jashtëligjshme.

**Kryesuesi i Kuvendit,** problemi se si është organizimi i punës së OJQ-ve jashtë, ajo nuk është pjesë e punës tonë. Unë nuk e di sesi funksionojnë forumet e OJQ, por nëse ka gjëra të tilla, duhet llogaritur vepër penale. Sido që të jetë, në emër të forumit të OJQ nga jashtë ka ardhur një dokument i nënshkruar, sigurisht ai person mban përgjegjësi për atë punë.

**z. Adnan Reka,** Ne jemi kundër për dy arsyë; E para, sepse rokadat e anëtarëve nga KKSB në këtë Komitet janë të paarsyeshme, të paktën për neve. Dhe e dyta, sepse është plotësisht në sh 'përputhje me Statutin e Komunës. Ju jeni mbështetur ne nenin 12 te Ligjit për VL, po ta shihni këtë nen mund ta kuptioni fare lehtë së kemi të bëjmë me shkelje ligjore. Ndërsa të gjithë abuzimin mundoheni ta arsyetoni përmes një UA.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Unë nuk kam qasje se çka bëjnë forumet e OJQ-ve. Ato janë vullnet dhe dëshirë e tyre Nuk është në kompetencë timen kjo çështje, ndërkëq nëse ka diçka në këtë drejtim, atëherë rrugën e dimë, është MAPL për me bërë Ankesë. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çështje se shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 7 anëtarë nga LVV (Ekrem Kyçyku, Adnan Reka, Agim Mani, Kaltrina Kodra (Tafili), Fatijona Kyçyku, Shemsedin Luzha dhe Albana Lika (Troni). Abstenuan 4 anëtarët si vijon: Ekrem Raka, Hafize Sallahi, Bekim Koxha dhe Selim Reka. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

#### VENDIM

Për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01.Nr.104/01-1879/18 i datës 28.02.2018-Për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi(KKSB), ashtu që:

1. Nga KKSB hiqet anëtari i përcaktuar si në pikën 2.14 të Vendimit, Kijani Sallahu - Përfaqësues i OJQ-ve, Mediat Lokale, Komuniteti i biznesit dhe Komuniteti i personave me aftësi të kufizuara.
2. Për anëtar të KKSB në pikën 2.14- Përfaqësues i OJQ-ve, Mediat Lokale, Komuniteti i biznesit dhe Komuniteti i personave me aftësi të kufizuara në vend të Kijani Sallahu, caktohet Remzi Reka - përfaqësues nga OJQ, Koordinator i Organizatës për Mbrojtjen e Mjedisit " Gjethi".

Lënda: 01Nr. 104/02-29023/20.

9. Propozim Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Për këtë pikë e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 7 anëtarët nga LVV. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

### VENDIM

**Për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu që në ora 12:00 e konstatoj mbledhjen e përfunduar. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KK.

Procesmbajtës:  
Makfire Malsiu




**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS  
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 207);**

**në Mbledhja e X -të (Dhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për  
vitin 2020, mbajtur me 23 Nëntor 2020;**

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma .....
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Shurdhani.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku .....
12. Agim Mani.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Tafili .....
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Troni.....,
23. Rabije Sallahi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi .....
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,.....



## Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 22. 12. 2020

Për: Anëtarët e Kuvendit: z. Ekrem Kyqyku,  
znj. Kaltrina Kodra  
z. Adnan Reka,  
z. Agim Mani,  
z. Bekim Koxha

### Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruara para Kuvendit të Komunës, më datë 23. 11. 2020, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

**z. Ekrem Kyçyku**, Fillimi i uroj festat e nëntorit, ndërkaq parashtroj këto pyetje: Është hera e katërt që parashtroj pyetje lidhur me realizimin e projektit, Shtrimin me kubëza të pjesës së rrugës në qytet. Pyetja ime ka qenë, A e ka tejkular afatin në realizimin e projektit kompania kontraktuese ? Nëse e ka kaluar afatin e realizimit të projektit, a i është shqiptuar gjobë kompanisë në fjalë?

- *Projekti “Ndërtimi i rrugës “Idriz Seferi”, projekt që është realizuar bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës, është realizuar brenda afatit kohorë të përcaktuar me kontratë të lidhur mes Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik. Kompania e kontraktuar ka finalizuar punimet sipas afatit të kontratës dhe gjithashtu i është përgjigjur të gjitha sanimeve të dëmtimeve që janë paraqitur brenda periudhës garantuese njëvjeçare.*

### z. Kaltrina Kodra

Tani po e ngriti një Kërkesë të cilën e kam pranuar nga f. Dubravë; Unë kam kontaktuar dhe kam vizituuar këtë fshat dhe i kam parë problemet e këtij fshati. Ndër kërkesat kryesore të këtij fshati është çështja e ujit. Po bëhen 1 vit apo më tepër që kur është ndërtuar rezervari i ujit ndërkaq komuniteti i këtij fshati nuk ka ujë. Lagja Imisht është një ndër lagjet që ka rezervuarin më së afërmë, ndërkaq kjo lagje nuk ka ujë fare, e mos të flasim për lagjet tjera. Lagjja Vataj nuk është e kyçur fare në ujësjellës. Në lagjen, Vataj e Epërme është problem mungesa e trotuarit dhe ndriçimit publik, që është nevojë e qytetarëve e sidomos për fëmijët të cilët vijojnë në shkollën në atë anë, të cilët shkojnë përmes rrugës kryesore. Kisha dashur me ditur, Kur do të bëhet ndriçimi dhe trotuari në atë pjesë ? Të lagja Dullovi, është bërë ndërtimi i një muri mbrojtës,

ndërkaq nuk është bërë drenazhi, me çka ka filluar toka të dëmtohen, qytetarët e asaj pjese janë mjaft të shqetësuar për këtë çështje.

- *Drejtoria e Shërbimeve Publike është në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësuesit e zgjedhur të lokalitetit të Dubravës (këshillat e fshatrave, këshilltarët komunal të këtij lokaliteti) lidhur me kërkesat dhe nevojat e tyre.  
Ju informojmë se komuna e Kaçanikut ka lidhur marrëveshje me KRU "Bifurkacioni"-njësia në Kaçanik për menaxhimin dhe mirëmbajjen e rrjetit të ujësjellësit të fshatit Dubravë. Mungesa e menaxhimit të këtij rrjeti ka rezultuar me këto probleme të cilat gradualisht do të rregullohen.*
- *Rregullimi i ndriçimit publik dhe ndërtimet e trotuareve janë pjesë e planifikimeve vjetore të drejtorisë dhe investimet do të bëhen sipas prioriteteve dhe arsyeshmërisë së tyre në çdo lokalitet, kurse rreth gjendjes së murit mbrojtës në lagjen Dullovi dhe mundësisë së punimit të drenazhës për ujra atmosferike do të angazhojmë inxhinierët për vlerësim të saj.*

**z. Adnan Reka,**

Kam një Kërkesë nga banorët e rrugës Lepenci, që t'ua shtroni rrugën që ende e kanë me baltë, ndërkaq për ndriçim publik as që bëhet fjalë për atë pjesë, ndoshta e konsideroni luks për ata banorë.

- *Rruga "Lepenci" është në listën e prioriteteve dhe do të realizohet vitin e ardhshëm në kuadër të projektit "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën urbane dhe rurale", kurse më pas do të shqyrtohen mundësítë e shtrirjes së rrjetit të ndriçimit publik siç jemi duke vepruar në të gjitha rrugicat tjera të zonës urbane.*

**z. Agim Mani,** Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë; Shqetësimi im dhe i qytetarëve është, hedha e mbeturinave në rrugën e quajtur "Rruga e Kuqe", e cila rrugë është 100 metra nga rruga magjistrale. Aty janë hedhur mbeturina të përditshme dhe kjo rrugë është bllokuar dhe po shndërrohet në deponi, me çka pos tjerash mund të jetë rrezik për qytetarët që kalojnë atypari nga qentë endacak.


- *Projekti "Largimi i deponive ilegale" është implementuar këtë vit dhe janë larguar një numër i konsiderushëm i deponive ilegale dhe janë vendosur shenjat informuese "Ndalohet hudha e mbeturinave" në të këto vende. Edhe në planifikimet e vitit të ardhshëm janë ndarë mjete buxhetore për këtë projekt dhe do të bëhet pastrimi i deponive ilegale të krijuara në lokacione të ndryshme, e me këtë rast edhe në rrugën e potencuar nga ju.*

**z. Bekim Koxha,** Shqetësimi i kahershëm banorëve të lagjes Koxhaj është çështja e ujit të pijes. Në f. Koxhaj nuk ka ujë jo vetëm sot por që 20 vite - nga pas lufta. Arsyet janë të ndryshme, drejtori ndoshta mundet me na dhënë sqarime më të hollësishme, sepse qytetarët janë duke pasur telashe në këtë drejtim, kur dihet se edhe bunarët kanë shterë. Kërkoj që drejtori të bëjë një farë plani për ujin e pijes, sepse banorët e asaj pjese janë në hall për ujin e pijes dhe nuk janë duke ditur se çka me bërë. Është mirë drejtori t'na tregoj së, A ka ndonjë projekt që në të ardhmen – brenda muajit me u bërë ndonjë zgjidhje për ujin e pijes të f. Koxhaj.

- *Komuna e Kaçanikut më datë 19.10.2020, pas sigurimit të dokumentacionit të pranimit teknik nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, ka lidhur marrëveshje me KRU "Bifurkacioni"-njësia në Kaçanik për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit përfshirat Dubravë, Doganaj, Soponicë, Koxhaj, Elezaj, Nikaj dhe Rekë. Tani kompetencat e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së këtij rrjeti janë të kompanisë së lartëcekur. Aktualisht është duke u punuar në sanimin e dëmtimeve të shkaktuara nga persona të pandërgjegjshëm në peshoret e dedikuara përrregullimin e sasisë së ujit për secilin lokalitet. Lagja Koxhaj, Gabrricë, Rakë, Sokoli dhe Berishë kanë të ndarë sasinë e ujit sipas projektit që rrjedh në rezervuarin e veçant me kapacitet  $100m^3$  dhe gypësjellës të veçant. Komuna e Kaçanikut është duke shqyrtuar mundësinë e rritjes së kapacitetit të prurjeve nga kaptimi i burimeve të reja apo edhe formave alternative (trajtimi i ujrate sipërfaqësor).*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,



Ramadush Osmani  
Drejtor i DSHPE-së



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

Për: Z. EKREM KYQYKU

Përgjigjeje, në pyetjen se a vlejnë ligjet e ndërtimit për të gjitha palë?

Pasi pytja nuk është e specifikuar ne mund të përgjigjemi shkurt,  
PO!

Ligji për ndërtim, vlen për të gjithë njëjtë si dhe të gjitha palët duhet të trajtohen në  
mënyrë të drejtë dhe të njëjtë, ashtu siq edhe janë trajtuar deri më tanı..

Drejtor i DUKMM  
Ukshin Çallaku